



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI I MJEKËSISË, TIRANË  
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 825/5 Prot.

Tiranë, më 07.04.2021

**VENDIM**

Nr. 25, datë 07.04.2021

**PËR MIRATIMIN E FONDEVE FINANCIARE, PËR MARRJEN E  
KONSULENCËS TË REALIZIMIT TË MARRËVESHJES PËR PROGRAMET E  
PËRBASHKËTA ME UNIVERSITETIN E BOLONJËS, ITALI, NË  
UNIVERSITETIN E MJEKËSISË, TIRANË**

Mbështetur në pikën 3/c, pika 4/ç, të nenit 3, pika 1 e nenit 108 të ligjit nr.80/2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet publike të arsimit të lartë, në Republikën e Shqipërisë", ligjin nr.9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, ligjin nr.162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik", Statutin e Universitetit të Mjekësisë, Tiranë, vendimin e Senatit Akademik nr.95, datë 07.10.2020 "Për dhënien e pëlqimit mbi marrjen e konsulencës teknike dhe ligjore mbi realizimin e marrëveshjes së bashkëpunimit me Universitetin e Bolonjës, Itali (Programe të përbashkëta studimi të ciklit të tretë të studimeve)" dhe në shkresën nr.2383/9 prot., datë 03.02.2021 "Mbi miratimin e fondeve për marrëveshje konsulence për doktoraturat" të Administratores së UMT-së, Bordi i Administrimit në mbledhjen e datës 07.04.2021,

**VENDOSI:**

1. Të miratojë fondet për realizimin e marrëveshjes me Universitetin e Bolonjës, Itali, për marrjen e konsulencës teknike dhe ligjore, për programe të përbashkëta studimi të ciklit të tretë të studimeve, në vlerën 4,607,133 (katërmilion e gjashtëqind e shtatë mijë e njëqind e tridhjetë e tre ) lekë.
2. Vlera e mësipërme të përfshihet në treguesit e buxhetit për vitin 2021, të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë.
3. Në përfundim të procesit të prokurimit, duhet të jenë të vlefshme jo më pak se dy oferta.

4. Ngarkohet Administratori i Universitetit të Mjekësisë, Tiranë, për zbatimin dhe publikimin e këtij vendimi.

5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARI**  
**Prof. Florian TOTI**



104/21